


VENDIMARRJA NË KËSHILLIN BASHKIAK DURRËS DHE PJESEMARRJA QYTETARE

# NJË MODEL TRANSPARENCE DHE LIGJSHMËRIE



National Endowment for Democracy  
*Supporting freedom around the world*



KËSHILLI BASHKIAK DURRËS



**GERTI SHELLA**

Drejtor Ekzekutiv,  
Qendra për  
Çështjet e  
Informimit Publik



**Një qytetar i  
informuar mbi  
vendimet që  
qeverisin qytetin,  
është padyshim një  
qytetar më imirë**

## Të nderuar qytetarë të Durrësit, Të nderuar përfaqësues vendorë në Këshillin Bashkiak,

Qendra për Çështjet e Informimit Publik (ÇIP) dhe dega e saj lokale në Durrës, Zyra e Transparencës Qytetare (ZTQ), që prej Majit 2011 janë duke punuar me përkushtim për të promovuar pjesëmarrjen qytetare në qeverisjen vendore dhe transparencën në vendimarrjen e Këshillit Bashkiak, mbështetur nga National Endowment for Democracy, NED, me seli në Washington D.C.

Motoja e punës sonë është: "*Qytetarët durrsakë duhet të  
dijnë se cfarë vendimesh merren në emër të tyre*". Një qytetar i informuar mbi normat që qeverisin qytetin, është padyshim një qytetar më i mirë. Për këtë arsy, ne dixhitalizuam vendimet e Këshillit Bashkiak që nga vitit 2007 e deri sot, duke i bërë ato të aksuesueshme për çdo qytetar përmes databazës on-line të vendimeve që i dhuruan Këshillit. Sot, në Shqipëri ka vetëm dy bashki me databaza të plota të vendimeve të Këshillave të tyre: Durrësi dhe Korça. Në të dyja rastet, ato janë ndërtuar dhe më pas i janë dhuruar atyre nga ÇIP.

Ne punuam për të sjellë më shumë qytetarë në sallën e Këshillit e Bashkiak. Falë ÇIP, të gjithë qytetarët e Durrësit kanë tashmë mundësi që të ndjekin edhe online, në një video-arkivë moderne të gjitha mbledhjet e Këshillit Bashkiak në audio-video.

Kjo qasje krejt unike, prezantuar dhe realizuar nga Qendra ÇIP, i shërben më së miri të gjithë qytetarëve durrsakë, brenda apo jashtë vendit, për të të qenë në dijeni të vazhdueshme të proceseve vendimarrëse në qytetin e tyre. Ajo i jep një dimension të ri transparency veprimtarisë së Këshillit Bashkiak, Durrës, duke e bërë atë kështu të vetmin në RSH, që disponon një video-arkivë të aktivitetit të vet vendimarrës (bashkë me Korçën), por edhe një lider në rajon sa i takon promovimit të transparencës në vendimarrje përmes teknologjive të reja të informacionit.

Në vitin tonë të parë të punës në Durrës, ne arritëm që, falë bashkëpunimit të shkëlqyer me kreun aktual të Këshillit Bashkiak, z. Indtit Hamiti, të implementojmë praktikisht funksionet ligjore të Këshillit për ndërmarrjen e konsultimeve publike përvendimarjet më të rëndësishme, siç janë ato për Paketën Fiskale dhe Buxhetin e Bashkisë (*4 takime të mëdha publike*).

Shpreh bindjen se ky bashkëpunim i nisur do ta konsolidojë me tej procesin e hapjes se Bashkisë së Durrësit ndaj qytetareve. Demokracia në nivel vendor nuk është një fazë kalimtare, por një komponent esencial dhe një detyrë e shoqërisë tonë kundrejt vetes, e gjithëpranuar tashmë nga 44 vende europiane që kanë ratifikuar Kartën Europiane të Autonomisë Vendore të KE, ku bën pjesë edhe Shqiperia.

Ju faleminderit



**INDRIT HAMITI**  
Kryetari i Këshillit  
Bashkiak, Durrës



**Sot krenohemi që mundëm të restaurojmë në 12 muajt e parë të mandatit, funksionet ligjore të Këshillit për ndërmarrjen e konsultimeve me publikun. Sot ne jemi realisht një model transparency dhe ligjshmërie**

### Të nderuar qytatarë të Durrësit,

Këshilli Bashkiak, të cilin kam nderin të kryesoj, është institucioni kryesor vendimarrës i Durrësit. Ai është parlamenti i qytetit tonë. Detyrë e Këshillit Bashkiak përvëç marrjes së vendimeve në të mirë të qytetarëve është që të garantoje edhe një mjesid diskutimi publik të fryshtëm dhe efikas për harmonizimin e këtyre vendimeve.

Ndërveprimi i nisur me aktorët vitalë të shoqërisë civile, dhe veçanërisht me Qendrën ÇJP dhe degën e saj në Durrës, Zyra për Transparency Qytetare, i ka shërbyer që në fillim qëllimit tim për ta hapur qeverisjen dhe përfshirë sa më shumë qytetarë dhe aktorë të interesuar në vendimarrje.

Kjo qasje ka prodhuar fryshtë e para, duke e ri-prezantuar publikun durrsak me procesin vendimarrës që ndodh në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak. Kjo sallë ka qëndruar e hapur për të gjithë dhe do të vijojë të jetë e tillë edhe në vitet në vazhdim, duke krijuar tashmë **një traditë të re, që promovon hapjen me publikun.**

Po ashtu, të gjitha vendimet që ne si këshilltarë vendorë kemi marrë në emrin tuaj, janë sot të aksuesueshme online nga çdo qytetar, duke e kthyer institucionin vendimarrës të qytetit tonë një model për t'u ndjekur nga të gjitha bashkitë e Republikës. Ne sot jemi i


vetmi Këshill Bashkiak në Shqipëri, mbledhjet e të cilit mund të ndiqen edhe online në çdo kohë, përmes video-arkivës që ka prodhuar bashkëpunimi ynë me Qendrën ÇJP.

Ne sot krenohemi që mundëm të restaurojmë plotësisht në 12 muajt e parë të ushtrimit të mandateve funksionet ligjore që i ngarkohen Këshillit Bashkiak për ndërmarrjen e konsultimeve me publikun në kuadër të vendimarrjeve për taksat dhe tarifat, buxhetin, mjesidin, etj.

Të gjitha këto arritje përfaqësojnë një standart të ri transparencë. Ato janë gjithashtu një model ligjshmërie për t'u ndjekur prej të gjithëve, pasi respektojnë pikë për pikë kërkosat e ligjit 8652 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore".

Në 12 muajt e dytë të ushtrimit të mandatit tim, unë, si kryetar i Këshillit do të synoj edhe restaurimin e funksioneve kontrolluese që vendimarrësi ka për detyrim ligjor të ushtrojë ndaj ekzekutivit të Bashkisë. Kjo do ta na sjellë të gjithëve më pranë, në një proces që e bën qytetin tonë më të mirë për qytetarët e vet përmes një qeverisjeje sa më të përgjegjshme.

**Ne tashmë jemi realisht një model transparency dhe ligjshmërie. Ky do të vijojë të jetë vizioni yne. Ky eshte misioni ynë i perbashket në muajt e ardhshëm.**



A screenshot of the official website for the Center for Integrity and Public Accountability (CIP). The page features the CIP logo at the top left, followed by a map of Albania and a large blue button labeled "Access". The main content area contains text about the database and links to various reports and documents. A sidebar on the right provides additional navigation options.

# Qendra ÇIP i dhuron Këshillit Bashkiak Durrës databazën online të vendimeve

Në datë 29 Shtator 2011, Qendra për Çështje të Informimit Publik dhe dega e saj në Durrës, Zyra për Transparencë Qytetare i dhuruan Bashkisë Durrës dhe gjithë qytetarëve dursakë Databazën Online të Vendimeve të Këshillit Bashkiak. Ceremonia e dhurimit u bë zyrtarisht në sallën e mbledhjeve të Këshillit, në fillim të seancës plenare të asaj dite.

Databaza e Vendimeve të Këshillit Bashkiak Durrës përmban të gjitha vendimet që prej vitit 2007. Falë bashkëpunimit me kreun e Këshillit Bashkiak z. Indrit Hamiti, kjo Databazë u linkua edhe në faqen zyrtare të Bashkisë Durrës.

Ajo garanton akses efikas në vendimet e Këshillit Bashkiak

Tij, e cila eshte zberthyer ne  
flamur, ne vule e medizioni. U ke  
i mundur mbas shpaljes se  
konkurenit per emblemen e qytetit  
nen kufijesh e Dredorise se  
Muzeut..



#### Formularë

Formular per rimbursim  
kase fiskale  
I mpreste  
Per Kryetarin  
Per Icje Taksi  
Per legalizim  
Per leje ndertimi  
Per leje shtrypzimi  
Per ndryshim destinacioni  
Per shesh ndertimi



për të gjithë të interesuarit, në mënyrë të thjeshtë, pa pagesë  
dhe në çdo kohë. Databaza i vjen në ndihmë gjithashu dhe  
Këshillit Bashkiak, i cili ka detyrimi ligjor të shpallë publikisht  
vendimet e tij.

Përdorimi i teknologjive të reja dhe hapja ndaj inovacionit  
është një ndër 12 Parimet e Qeverisjes së Mirë dhe  
Demokratike të Këshillit të Evropës. Në këtë kuptim, Këshilli  
Bashkiak, Durrës përfaqëson sot një model europian të  
vendimarrjes së hapur dhe transparente.

Aktualisht në RSH ka vetëm dy bashki që disponojnë  
databaza të rregullta online të vendimeve të Këshillit: Durrësi  
dhe Korca. Në të dyja rastet, databazat janë prodhuar dhe

më pas i janë dhuruar Këshillave respektive nga Qendra për  
Çështje të Informimit Publik dhe degët e saj lokale, të  
quajtura Zyrat e Transparencës Qytetare.

Ky është gjithashu një model të ri qasjeje për organizat  
e shoqërisë civile në promovimin e qeverisjes së mirë dhe  
transpencës, në respekt të plotë të normës që cakton ligji.

**"Qytetarët  
durrsakë duhet të  
dinë se çfarë  
vendimesh merren  
në emër të tyre"**

Shih fotot në: [http://www.infocip.org/al/?page\\_id=151&album=3&gallery=21](http://www.infocip.org/al/?page_id=151&album=3&gallery=21)

Shih videot në: <http://www.infocip.org/al/?p=2696>



## Këshilli Bashkiak Durrës dhe ÇIP organizojne diskutimin e Paketës Fiskale 2012 me grupet e interesit

Këshilli Bashkiak, Durrësit, mbështetur nga Qendra ÇIP dhe dega e saj lokale, Zyra e Transparencës Qyterare, organizuan ditën e mërkurë, dt. 21 Dhjetor 2011, takimin e madh publik me temë: **"Paketa Fiskale 2012 – diskutimi i Këshillit Bashkiak me grupet e interesit & publikun"**.

Në takim morën pjesë përfaqësuesit e Dhomës së Tregtisë

dhe Industrisë Durrës, Shoqatës së Ndërtuesve, komuniteti të bisnesit të vogel, industriisë "fason". Të pranishëm ishin edhe një numër i konsiderueshëm këshilltarësh bashkiakë si dhe dhjetëra qytetarë.

Kryetari i Këshillit Bashkiak, Idriz Hamiti, pasi falenderoi Qendrën ÇIP, theksoi se ky takim është një tregues i dobisë



së madhe publike, në respekt të plotë të ligjit, që prodhon bashkëpunimi mes vendimarrësve vendor dhe aktorëve të specializuar të shoqërisë civile, sic është Qendra ÇIP, për një vendimarrje sa më transparente.

Sic theksoi më pas edhe përfaqësuesi i ÇIP, G. Shella, diskutime të tilla publike janë një detyrim i pastër ligjor të cilin ligji 8652 ia ngarkon Këshillave Bashkiak dhe jo kryetarëve të Bashkisë, (sikurse është *keq-implementuar rëndom deri më sot*)". Dhe në fakt, diskutimi i **Paketës Fiskale 2012** me grupet e interesit në Durrës u organizua për herë të parë duke patur si protagonist Këshillin Bashkiak, duke e ripërcaktuar këtë të fundit si një model ligjshmërie dhe transparence përtë gjithë

vendimarrësit e tjerë vendorë në Shqipëri.

Gjatë diskutimit dolën mjaft propozime për ndryshime në draftin e paketës fiskale, si: heqja ose ulja e taksës së fjetjes në hotel, ulja dhe diferencimi i tarifës së pastrimit, dhënia në përdorim me konkurs e plazheve private, ulja e taksave përbiznesin e vogël, rajonalizimi fiskal i qytetit, etj. I gjithë takimi u regjistrua në audio-video dhe u upload enë në [ëebaletin e ÇIP](http://www.infocip.org) [www.infocip.org](http://www.infocip.org), i cili është i linkuar direkt nga faqja zyrtare e Bashkisë Durrës <http://www.durres.gov.al/>



Shih fotot në: [http://www.infocip.org/a/?page\\_id=151&album=3&gallery=23](http://www.infocip.org/a/?page_id=151&album=3&gallery=23)



Shih videot në: <http://www.infocip.org/a/?p=3553>

Nuk ka rastmë të  
mirë se sa diskutimi  
i taksave dhe  
tarifave vendorepër  
të promovuar  
pjese marrjen  
publikut në  
vendimarrje,  
transparencën  
qeverisës dhe  
respektin ndaj ligjit



## Miratohet Paketa Fiskale 2012, pranohen rekomandimet e dala nga diskutimi me grupet e interesit

Pas diskutimit publik të Paketës Fiskale 2012 me grupet e interesit, Qendra ÇIP dhe dega e saj në Durrës, Zyra për Transparencë Qytetare zbardhën të gjitha rekomandimet e takimit. Një dosje e plotë, që përbante procesverbalin e takimit, trajtesat, kërkesat, diskutimet në sallë, si dhe një ekstrakt i rekomandimeve iu vu në dispozicion Këshilltareve,

me synim njojen e thelluar të rekomandimeve të këtij diskutimi publik përpëra momentit të vendimarrjes. Në dosje ishin përfshirë edhe DVD ku aktiviteti ishte i regjistruar i gjithë në audio-video.

Më 17 Janar 2012, Këshilli Bashkiak i Durrësit miratoi Paketën Fiskale duke i bërë ndryshime draftit të Bashkisë,



bazuar mbi rekomandimet e takimit me grupet e interesit. Një pjesë e taksave dhe tarifave vendore nuk u rritën, duke mbetur në nivelin e viti 2011.

Praktika e informimit të dyfishtë si të grupeve të interesit, ashtu edhe të vendimarrësve, e cila u aplikua për herë të parë në Durrës, provoi më së miri efikasitetin e saj në dobi të grupeve të interesit, por edhe të Këshillit, i cili pati mundësi të zbatojë rigorozisht ligjin 8652 dhe njëkohësisht të harmonizojë vendimarrjen e tij mbi taksat dhe tarifat vendore.

Një process i tillë do të kishte qenë pothuajse i pamundur, pa ndihmësën dhe vullnetin pozitiv të demonstruar nga kryetari i Këshillit Bashkiak, Z. Indrit Hamiti, i cili u përfshi

personalisht në të gjitha fazat e këtij procesi duke u ktheer këtë procès në një model suksesi të konsultimeve publike të ndërmarra direct nga Këshilli Bashkiak, vendimarrësi real i qytetit.

Kurse Metoda e Informimit të Dyfishtë (MID) është një tjetrë risi që Qendra ÇIP prezantoi me sukses në kuadër të ndërveprimit të saj me vendimarsit lokale, e cila mund të shërbejë si një model autentik për të gjitha organizatat e tjera.



Shih fotot në: [http://www.infocip.org/al/?page\\_id=151&album=3&gallery=29](http://www.infocip.org/al/?page_id=151&album=3&gallery=29)



Shih videot në: <http://www.infocip.org/al/?p=6200>



## Diskutimi i Projekt-Buxhetit 2012, ÇIP dhe Këshilli Bashkiak organizojnë Tryezën për Mjedisin me grupet e interesit

Këshilli Bashkiak i Durrësit në bashkëpunim me Qendrën ÇIP dhe degen e saj lokale Zyrën e Transparencës Qytetare, organizuan në 9 Mars 2012, takimin me temë: "**Tryeza për mjedisin me aktorët e interesuar – në kuadër të hartimit të buxhetit të Bashkisë Durrës 2012**". Ky takim i madh publik synonte rritjen e pjesëmarrjes dhe ndërveprimin mes

aktorëve të interesuar në vendimarrjen për Buxhetin 2012 të Bashkisë Durrës. Kjo e bën këtë të parin takim të madh publik për diskutimin e buxhetit të mbajtur ndonjëherë në qytetin e Durrësit, ku protagonist është Këshillit Bashkiak, në koordinim të plotë të shoqërinë civile.



Mes çështjeve të rëndësishme që u ngritën në takim ishin ndërtimi i një landfilli për ngrumbullimin dhe përpunimin e mbetjeve, shfrytëzimi i energjive alternative, efektiviteti i mbledhjes së taksave për pastrimin e qytetit, gjelbërimi, rehabilitimi i mjediseve të ndotura, etj.

Kjo tryezë përcakton një standart të ri dhe një model jo vetëm në nivel lokal, por edhe kombëtar, ku procesi i konsultimeve për buxhetin udhëhiqet në të gjitha hallkat direkt nga Këshilli Bashkiak, i cili është edhe vendimarësi ekskluziv i buxhetit vendor. Mbi të gjitha, ky është një detyrim i pastër ligor (neni 35, ligji 8653 "Per organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", i ndryshuar) për Këshillin

Bashkiak, dhe jo në të vërtetë per krerë e Bashkive, të cilët kanë udhëhequr me raste procese ekstra-ligjore konsultimesh, edhe pse në fakt nuk kanë tagër ligjor vendimarrës, por vetëm ekzekutues të buxheteve që cakton Këshilli Bashkiak.



Shih fotot në: [http://www.infocip.org/al/?page\\_id=151&album=3&gallery=32](http://www.infocip.org/al/?page_id=151&album=3&gallery=32)



Shih videot në: <http://www.infocip.org/al/?p=6961>



## Diskutohet Projekt-Buxheti 2012 edhe me grupimet gjinore në Durrës



DT 24 MAJ 2012

Rrjeti i Grave  
"Barazi në  
Vendimmarrje"  
bëhet pjesë e  
debatit publik për  
buxhetin 2012

Në vazhdën e procesit të diskutimeve publike para miratimit të Buxhetit 2012, Kryetari Këshillit Bashkiak në Durrës, z. Indrit Hamiti së bashku me Rrjetin e Grave "Barazinë Vendimmarrje" prezantuan para mediave në dt. 24/Maj 2012 "Platformen Virtuale të Grave në Vendimmarrje". Kjo nisëm synonte forcimin e infrastrukturës së komunikimit dhe rritjen e pjesëmarrjes së femrave në të gjitha proceset sociale dhe në strukturat vendimarrëse, duke u kriuar atyre shanse për informim më të mirë, për pjesëmarrje më të lartë dhe cilësore në proceset vendimarrëse, si dhe për mbështetjen e barazisë gjinore në vendimarrjen politike për fushat kyçë të

zhvillimit të qytetit. Kjo mundëson përafrimin e tyre akoma më shumë me nismat e Këshillit Bashkiak me synim e një perfaqësimi sa më dinjitoz të gruas në vendimarrje. Kryetari i Këshillit Bashkiak z. Indrit Hamiti, theksoi në tryezë rëndësinë e diskutimit të Draft Buxhetit 2012, duke e bashkëlidhur me problemet dhe sfidat e grave dhe zgjidhjen e tyre përmes buxhetit të qytetit. Përfshirja e grupimeve gjinore në diskutimin publik për buxhetin është një tjetër risi e procesit të konsultimeve për buxhetin 2012 që u zhvillua në Durrës me protagonist Këshillin Bashkiak përmes partneritetit me shoqerinë civile.



## Administrata e Bashkisë mbron projekt-Buxhetin 2012 para publikut dhe këshilltarëve



**DT 25 MAJ 2012**

**Kryetari i Këshillit  
Bashkiak, z. Indrit  
Hamiton  
administratën lartë  
të Bashkisë të  
prezantojë publikisht  
projekt-Buxhetin  
2012.**

Diskutimet publike me komunitetin pér Buxhetin 2012, tē iniciuara si një bashkëpunim mes Këshillit Bashkiak Durrës dhe Qëndrës ÇIP, vijuan në datë 25 Maj me një aktivitet autentik, ku nënkyetari i Bashkisë, z. Adrian Çela, shpalosi para një audience me aktorë tē rëndësishëm publikë në qytetin e Durrësit, të gjitha pikat e projekt-Buxhetit 2012 të përgatitur nga administratë e bashkisë Durrës. Z. Çela bëri një prezantim tē hollësishëm tē zërave tē projekt-Buxhetit para tē pranishmëve në sallë. Përmes argumentave dhe shembujve krahasues me vitet e kaluara, nënkyetari i

bashkisë mbrojti projektin e hartuar nga admisnitrata bashkiake dhe kërkoi mbështetjen e vendimarrësve në Këshillin Bashkiak pér kalimin me votë tē këtij projekti.

Çela përgëzoi nismën e z. Hamiti dhe partnerë e Këshillit Bashkiak nga shoqërisë civile (Qendra ÇIP, Zyra pér Transparency Qytetare) pér restaurimin dhe promovimin e funksioneve ligjore tē Këshillit Bashkiak pér diskutimin e buxhetit me grupet e interesit dhe publikun. Ai shtoi se administrata e bashkisë, edhe pse nuk e ka detyrim ligjor, ka krijuar gjithsesi një traditë pozitive në këtë drejtim gjithashtu.



## Projekt-Buxheti 2012, zëri për arsimin konsultohet me drejtorët e shkollave e nxënësit tek "Jan Kukuzeli"

Qendra ÇIP, në bashkepunim me Keshillin Bashkiak, Durrës organizuan konsultimin publik "Per Buxhetin e Arsimit, 2012". Në takim morën pjesë kryetari i këshillit bashkiak, Indrit Hamiti, nënëkryetari i Bashkisë Durrës, Ardian Çela, drejtori i drejtorisë arsimore të Durrësit, Filip Gjoncaj, pothuaj të gjithe drejtorët e shkollave në qytetin e Durrësit

(gjithësej 90 pjesëmarrës).

Takimi u organizua jo pa qëllim në sallën e koncerteve të Shkollës Artistike "Jan Kukuzeli". Kjo shkollë, edhe pse përfaqëson traditën më të hershme në edukimin e brezit të ri në Durrës, sot përballet me nevoja urgjente për përikontruksionin e godinës mjaft të amortizuar.



Pothuajse nga të gjithë pjesëmarrësit u tha haptas se shifra 6 për qind në buxhetin 2012, e caktuar nga adminisnitrata e bashkisë për ishte e pamjaftueshme. Në takim u kërkuar që kjo shifër të ngríhej deri në 10% të buxhetit vjetor të bashkisë.

Kryetari i Këshillit Bashkiak në Durrës, Z Hamiti, falenderoi Qendrën ÇIP për organizimin e këtij takimi që ai e cilësoi shumë të rëndësishëm. "Tryeza për Arsimin që zhvillojmë sot merr një kuptim të veçantë. Përvec se mesuesve dhe edukatorëve të tyre, cështjet e arimit i interesojnë në radhë të parë fëmijëve

tane. Një pjesë e tyre janë sot me ne të pranishëm në këtë sallë, duke shënuar një standart të ri të pjesëmarrjes së vetë atyre në vendimarrjen publike që i prek ata drejtpërdrejt, sikurse është arsimi", tha z. Hamiti.

Takimi i madh publik për arsimin përmbylli serinë mjaft të rëndësishme të konsultimeve publike për buxhetin 2012, organizuar në partneritet mes Këshillit Bashkiak dhe Qendrës për Çështjet e Informimit Publik dhe degës së saj lokale, Zyra për Transparencë Qytetare, Durrës

Shih fotot në: [http://www.infocip.org/al/?page\\_id=151&album=3&gallery=36](http://www.infocip.org/al/?page_id=151&album=3&gallery=36)

Shih videot në: <http://www.infocip.org/al/?p=7409>

Pa një buxhet te studiuar mire dhe te diskutuar me administratorët arsimit, mesuesit, dhenxënësit, nuk mund te krijohen kushtë optimale përtë paturnje edukim cilësor



## Miratohet Buxheti Bashkiak 2012. Sukses i Këshillit dhe i ÇIP: Arsimi nga 6 shkon ne 10 përqind

Pas rrëth 6 orë debatesh, Këshilli Bashkiak miratoi Buxhetin 2012 të Bashkisë e Durrësit. Ky ka qenë padyshim moment më kulmori i vepritarës vendimarrëse të Këshillit Bashkiak, Durrës.

Çështje e nxjehtë diskutimesh ka qenë buxheti për arsimin, i parashikuar fillimisht 6% nga admisnitrata e Bashkisë. Këshilltarët me shumicë votash vendosën rritjen e zërit të investimeve në buxhet për arsimin (rikonstrukcionin e

shkollave) me rrëth 51 milion e 300 mijë lek. Kjo e çoi praktikisht nga 6% në 10% zërin për arsimin, çka përkon pikë për pikë me kërkesën e arsimtarëve durrsakë të shprehur hapur në takimin konsultativ organizuar ÇIP dhe ZTQ në Durrës dy javë para mbledhjes së Këshillit ku u miratua Buxheti.

Nga kjo shtesë në buxhetin për arsimin, rrëth 25 milion lëke u caktuan për rikonstruksionin e shkollës "Sami Frashëri", kurse



26 milione 300 mijë për rikonstruktion e shkollës "Jan Kukuzeli".

Në vija të përgjithshme, buxheti bashkiak i Durrësit nga rrëth 1 miliard e 729 milion u rrit në 1 miliard e 784 milion. Kjo rritje kryesiht shkon në investimet në ato fusha që u kërkuau nga qytetarët gjatë programit të konsultimeve publike që u organizua nga Këshilli Bashkiak, Durrës në bashkëpunim të ngushtë me ÇIP dhe ZTQ Durrës.

Në mënyrë të posaçme, rritja afersisht 10% e buxhetit të arsimit, përfaqëson një histori suksesi të padiskutueshme të ndërveprimit midis vendimarrësve lokale dhe shoqërisë civile. Kryetari i Këshillit Bashkiak, Indrit Hamiti, u shpreh i kënaqur në përfundim të seancës. Ai përgëzoi dhe falenderoi anëtarët

e ZTQ të pranishëm në sallën e mbledhjeve të Këshillit "për këtë sukses të përbashkët".

Programi ikonsultimevetë Këshillit Bashkiak me komunitetin i prezantuar nga Qendra ÇIP është një risi e jetës publike në qytetin e dytë më të madh të vendit, një standart i ri në respekt të plotë ndaj ligjit dhe ndaj qytetarëve. Kulmimi i këtij procesi padyshim që ka qenë miratimi me sukses i Buxhetit 2012.



Shih fotot në: [http://www.infocip.org/al/?page\\_id=151&album=3&gallery=39](http://www.infocip.org/al/?page_id=151&album=3&gallery=39)



Shih videot në: <http://www.infocip.org/al/?p=7425>

**Databaza Elektronike e Akteve**

HOME

RRETH NESH

KU PUNOJME

AKTIVITETE

PUBLIKIME

FORUM

KONTAKT



Dt 24.11.2011, pj. II from Qendra CIP on Vimeo.

**KESHILLI BASHKIAK DURRES**

Videocarkiva e mbledhjeve te Keshillit Bashkiak, Durrës (Gusht 2011 deri sot...) Kliko ketu per te pare diskutimet publike te Keshillit Bashkiak, jashte salles se mbledhjeve



Mbledhja e Keshillit Bashkiak Dumes , Dt 20.12.2011



Mbledhja e Keshillit Bashkiak Dumes , Dt. 06.06.2012



Tryeza per Mjedise, diskutimi per Buxhetin 2012 (Pj 1) Dumes , dt. 09.03.2012



Tryeza per Mjedise, diskutimi per Buxhetin 2012, pj 2 dumes 09.03.2012



Mbledhja e Keshillit Bashkiak Dumes , Dt 22.09.2011



Mbledhja e Keshillit Bashkiak Dumes , Dt 09.10.2011



Mbledhja e Keshillit Bashkiak Dumes Dt 24.11.2011, pj. II



Takim me Bizneset 21.12.2011, Keshilli Bashkiak

**Shiko mbledhjet e Keshillit Bashkiak ne Audio & Video**

# Video-arkiva e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak, Durrës, atje ku inovacioni promovon transparencën

Qytetarët e Durrësit kanë tashmë mundësi që të ndjekin e mbledhjet e Këshillit Bashkiak edhe online, përmes faqes së Qendrës ÇIP, [www.infocip.org](http://www.infocip.org), e linkuar tashmë në faqen zyrtare të Bashkisë Durrës. Të gjitha mbledhjet e zhvilluara nga Këshilli i ri Bashkiak që doli pas zgjedhjeve të Majit 2011, janë filmuar nga Qednra ÇIP dhe më pas janë uploaduar online në një video-arkivë moderne.

Kjo qasje krejt unike, prezantuar dhe realizuar nga Qendra ÇIP, i shërben më së miri të gjithë qytetarëve durrsakë, brenda dhe jashtë qytetit të tyre, (brenda apo jashtë vendit), për të të qenë të në dijeni të vazhdueshme të proceseve vendimarrëse që realizohen në qytetin e tyre.

Ajo i jep një dimension të ri transparence veprimtarisë vendimarrëse të Këshillit Bashkiak, Durrës, duke e bërë atë kështu të vetmen bashki në Republikën e Shqipërisë, që disponon një video-arkive online të aktiviteteve vendimarrëse të saj. Kjo video-arkive e bën Këshillin Bashkiak Durrës edhe një lider në rajon sa i takon

promovimit të transparencës në vendimarrje përmes teknologjive të reja të informacionit.

Dokumentim rigoroz në audio-video i mbledhjeve të Këshillit Bashkiak, Durrës është shumë i rëndësishëm edhe për vlerësimin prej cilitdo të interesuar të modalitetave ligjore të vendimarrjes në nivel vendor.

Kjo video-arkive përfaqëson një vlerë të shtuar të projektit ne terësi që ÇIP ariti të implementojë në Durrës, në bashkëpunim të ngushtë me Këshillin Bashkiak të kryesuar nga z. Indrit Hamiti, mbwshtetur nga National Endowment for Democracy, NED, me seli në Washington D.C.

Videoarkiva përban të gjitha mbledhjet e Keshillit Bashkiak, qe nga muaji Gusht 2011 dhe vijon të uploadohet rregullisht edhe në ditët e tanishme.



Shih videoarkivën në: [http://www.infocip.org/al/?page\\_id=271](http://www.infocip.org/al/?page_id=271)



Web: <http://www.infocip.org>  
E-Mail: [qendra@cip.al.org](mailto:qendra@cip.al.org)  
Tel/Fax: +355 (0) 44507771